

VENDIM
Nr. 371, datë 26.12.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SWISS BALANCING POOL” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13 “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2302/14 prot., datë 19.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Swiss Balancing Pool’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2302 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 311, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.11.2023 dhe 2.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 1.11.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar/plotësuar pjesërisht, shkresë e cila u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, me shënimin “I panjohur” ndaj në vijim shoqëria u njoftua nëpërmjet adresës së e-mail-it të lënë në kuadër të aplikimit.

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. me shkresat nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023 dhe nr. 2302/8 prot., datë 24.11.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj duke bërë me dije se nuk ka marrë njoftim zyrtar, por është njohur me vendimin nr. 311/2023 nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të ERE-s.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar dhe nevojës për të vazhduar korrespondencën me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 358, datë 1.12.2023 vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare mbi licencimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën me nr. 2302/10 prot., datë 6.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimmarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit, dhe i ka sjellë në konsideratë se për të zhvilluar korrespondencën në rrugë shkresore me ERE-n shoqëria duhet të bëjë me dije një adresë të vlefshme.

- Në vijim subjekti me shkresën me nr. 2302/11 prot., datë 12.12.2023 ka konfirmuar adresat përmes të cilave do të zhvillohen korrespondencat në rrugë shkresore dhe elektronike.

- Me shkresën me nr. 2302/12 prot., datë 13.12.2023, ERE njoftoi shoqërinë se në kuadër të plotësimit të një dosjeje të plotë, subjekti duhet të depozitojë vërtetimin lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, se ka shlyer të gjitha detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dokumentacion i cili është përcjellë në ERE me shkresën e fundit me nr. 2302/13 prot., datë 14.12.2023, nga shoqëria.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrje së vendimit, rishikimin e vendimi të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti